

Bashkia Berat

Adresa : Rruga Antipatreas, Berat 5001,
<https://bashkiaberat.gov.al>

Për ne integrimi evropian nuk është vetëm një nevojë. Është një sfidë, por edhe një detyrim ndaj qytetarëve tanë. Në duhet ta njehim Europën, ta vlerësojmë atë, të përfitojmë prej kontributit të BE dhe të japim kontributin tonë gjithashtu. Merat e BE janë të emuara për në. Ne i vlerësojmë ato dhe duam të jemi një kontribut i shtuar për Europën

Krijimi i Drejtorisë së Integritimit Evropian dhe Projekteve

Kjo drejtori u krijua me iniciativë dhe vendim të Kryetarit të Bashkisë, me qëllim koordinimin e veprimtarisë për aplikim dhe zbatim të projekteve të mbështetura nga donatorët, kryesisht me financime nga BE.

Stafi i Drejtorisë

Pjesëtarët e strukturës përgjegjëse të bashkisë për projektet me BE janë nëpunës civil me një eksperiencë disa-vjeçare në bashki. Përzgjedhja e pjesëtarëve të strukturës së projekteve është një proces i rëndësishëm dhe i kujdesshëm. Në procesin e zgjedhjes së pjesëtarëve prioritarë ka qenë vlerësimi i aftësive, përvojës dhe personalitetit të tyre. Gjithashtu janë vlerësuar aftësia për të menaxhuar projekte me sukses, aftësia për të komunikuar efektivisht me të gjitha palët e interesuara, duke përfshirë ekipin, donatorët, partnerët dhe komunitetin, aftësia për të menaxhuar ekipin e projektit, duke përfshirë rekrutimin, trajnimin, motivimin dhe udhëzimin e stafit, aftësia për të identifikuar problemet, analizuar situatat komplekse, dhe gjetur zgjidhje efektive, etj.

Bashkëfinancimi

Një pjesë e konsiderueshme e projekteve kërkojnë bashkëfinancim nga ana e bashkisë në masën 20%. Ne e parashikojmë atë në buxhetin e bashkisë dhe ofrojmë kontributin tonë në bashkëfinancim.



Projekte të financuara nga BE

Viti 2021

3 projekte të fituara

Viti 2022

21 projekte të fituara

Viti 2023

10 projekte të fituara

Projekte të financuara nga BE

Totali fondeve të përfituara nga projektet e financuara nga BE në tre vitet 2021-2023 arrin në vlerën 6,190,656 Euro

“Projekti për mbrojtjen nga zjarri (FIRE PREP- IPA)” me vlerë 826,000 euro. I domosdoshëm dhe me një impakt të madh në sigurinë e qytetit në mbrojtjen nga zjarri.

“Projekti për shërbimet arsimore (Bashkimi Evropian)” me vlerë 200,000 euro, i cili ka një ndikim direkt në cilësinë e procesit mësimor dhe në përgatitjen e brezave të rinj. Restaurimi i shkollave dhe kopshteve si dhe krijimi i Qendrës Multifunktionale Arsimore i jep mundësinë të rinjve të arsimohen dhe zhvillohen me ritmin e duhur dhe në kushtet e duhura.

“Projekti për mjetet e shërbimeve publike (TAP)” me vlerë 725,000 ka rritur ndjeshëm cilësinë dhe efikasitetin e shërbimeve në qytet.

Vlerësimi i thirrjeve

Ka shumë thirrje të donatorëve në lidhje me projektet e financuara prej tyre në shërbim të qytetarëve. Ne vlerësojmë ato thirrje të cilat janë në harmoni me politikat e Bashkisë. Vlerësohet gjithashtu edhe kapaciteti për të përballuar zbatimin me sukses të projektit. Në rastet kur thirrjet e shpallura nuk janë në përputhje të plotë me nevojat e Bashkisë, përshtatjes së tyre me kërkesat e komunitetit dhe prioritetet tona, i kushtohet një rëndësi e vecantë

Pjesëmarrja komunitare

Pjesëmarrja komunitare në çdo fazë të zhvillimit të projektit është prioritet për ne. Nga ana e strukturave përkatëse të bashkisë realizohen në mënyrë periodike dëgjesa publike me grupet e interesit në lidhje me projektet nga të cilët ata kanë përfitime direkte. Kemi eksperiencë pozitive nga takimet me komunitetin, jo vetëm për të identifikuar nevojat e tyre, por edhe për të marrë opinionin dhe vlerësimin e tyre në lidhje me projektet e realizuara. Në fund të fundit gjithçka ju dedikohet qytetarëve dhe është në shërbim të tyre.

Përputhja me Planin e Zhvillimit Strategjik

Në përgjithësi aplikimet tona adresojnë kryesisht nevojat më kryesore që bashkia ka. Sigurisht që kërkesat dhe nevojat me prioritet mund të ndryshojnë çdo vit. Në varësi të tyre do përshtaten edhe aplikimet për projekte të ndryshme. Por mbetën gjithmonë prioritet nevoja për projekte që sjellin zhvillimin ekonomik. Projekte që promovojnë rritjen ekonomike, punësimin, mbrojtjen e monumenteve, energjinë e gjelbër, përmirësimin e infrastrukturës, etj - janë prioriteti ynë. Projekte që promovojnë të drejtat njerëzore, barazinë gjinore, mbrojtjen e fëmijëve dhe grupeve të ndjeshme, si dhe luftën kundër diskriminimi, janë gjithashtu prioritet.

Transparenca

Transparenca dhe llogaridhënia janë të rëndësishme për ne. Nëpërmjet faqes zyrtare të bashkisë dhe rrjeteve sociale informojmë publikun për çdo projekt që bashkia është duke realizuar. Informimi i publikut bëhet në vijimësi në çdo fazë të zbatimit të projektit. Të gjithë projektet i kemi pasqyruar në faqen zyrtare të bashkisë si dhe në rrjetet sociale zyrtare. Në secilin prej tyre prezantojmë qartë një përmbledhje rreth donatoreve, realizimin dhe impaktin që këto projekte kanë në komunitet.

Vijimësia

Garantimi i vijimësisë së punës së mirë është një sfidë e rëndësishme për ne. Ne jemi të përqëndruar në forcimin e kapaciteteve të stafit dhe në hartimin e një plani afatgjatë duke identifikuar në kohë objektivat dhe prioritetet. E rëndësishme për ne është edhe diversifikimi i burimeve financiare.



Përfitimet

Ne kemi mësuar shumë dhe jemi në proces mësimi të vazhdueshëm. Ne dëshirojmë gjithashtu të ndajmë përvojën tonë me bashkitë e tjera. Të gjithë së bashku mund të arrijmë shumë më shumë. Kjo është një vlerë europiane që ne e kemi përqaftuar.

Suksesi ynë i dedikohet pasionit, përkushtimit, transparencës dhe bashkëpunimit me të gjithë aktorët lokalë dhe qendrorë

Objektiva për të ardhmen

- Forcimi i kapaciteteve të stafit të Bashkisë.
- Hartimi i Regullores së funksionimit të Drejtorisë së Integritit European dhe projekteve me qëllim forcimin e rolit koordinues.
- Përmirësimi i infrastrukturës së drejtorisë me qëllim vijimin e punës së suksesëshme në drejtim të hartimit dhe realizimit të projekteve me donatorët.
- Krijimi dhe forcimi i marrëdhënieve të mira me komunitetin si një kusht thelbësor për vijimësinë e punës dhe garantues i suksesit.
- Bashkëfinancimi dhe angazhimi i komuniteteve vendore në të gjitha fazat e realizimit të projekteve – si bazë për transparençën dhe llogaridhënien ndaj komunitetit.